



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

Legjislatura e III-të

Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport e Telekomunikacion

Mbledhja e datës 12.02.2008

Salla: N-225, ora 10.00

Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës

Procesverbal

Në mbledhje morën pjesë: Myzejene Selmani - kryetare e Komisionit, Sllobodan Petroviq – zëvendëskryetar i dytë, Safete Hadergjonaj, Sala Berisha- Shala, Fatmir Rexhepi, Zef Morina, Berim Ramosaj dhe Mufëra Şinik.

Munguan: Et'hem Çeku, Haki Shatri dhe Kaqusha Jashari.

Poashtu morën pjesë stafi mbështetës në përberje: Hasan Tahiri, Advije Morina, Armend Ademaj si dhe përfaqësues nga OSCE-ja Petrit Hysaj, nga USAID-i Elizzabet Vikstorm-Bajrami, Valon Novosella dhe Korab Sejdiu, nga Presidenca Lumnije Murati, nga NDI-ja Vjosa Bajrajliu dhe KDI-ja Fitore Zeneli.

Rendi i ditës:

- 1.Konsituimi i Komisionit;
- 2.Njohja reciproke e anëtarëve të Komisionit dhe të stafit mbështetës;
- 3.Fushëveprimi dhe përcaktimi në parim për formën e punës së Komisionit ;
- 4.Të ndryshme;

Rendi i ditës u miratua pa vrejtje.

Mbledhjen e hapi: Myzejene Selmani, kryetare e Komisionit.

1.Lidhur me pikën e parë, kryetarja se pari prezantoi veten, pastaj kërkoj që këtë të bejnë edhe anëtarët e tjerë të komisionit secili veç e veç, duke sqaruar statusin e anëtarit në Komision dhe eksperiencën e tyre profesionale.

2. Njohja reciproke e anëtarëve të Komisionit dhe të stafit mbështetës ishte pika e dytë e rendit të ditës, ku Kryetarja e Komisionit i njoftoi anëtarët e Komisionit me stafin mbështetës (Hasan Tahiri kordinator i komisionit, Advije Morina zyrtare e lartë ligjore dhe Armend Ademaj zyrtar ligjor) të cilët do ta mbështesin Komisionin në pikpamje profesionale dhe teknike. Poashtu përshendeti edhe përfaqësuesit e organizatave të akredituara në Kosovë dhe institucionet tjera relevante të cilat do ta mbështesin Komisionin si OSCE, USAID-i, NDI, KDI etj. të cilët i ftoj për bashkepunim dhe mbështetje.

3. Në pikën e tretë të rendit të ditës Kryetarja në pika të shkurtra ua përkujtoi fushëveprimtarinë e Komisionit duke theksuar që Komisioni ka të bëjë më fushat e ekonomisë, industrisë, tregtisë, energjetikës, transportit dhe telekomunikacionit që i përcjell dhe i mbulon këto fusha. Komisioni gjatë ushtrimit të funksionit do të jetë konceptimi i strategjisë së përgjithshme për zhvillimin a këtyre aktiviteteve dhe do të zgjedhë format dhe metodat më të përshtatshme për të qenë azhur, efektivë dhe cilësorë. Për t'i arritur objektivat e veta Komisioni, në kuadër të kompetencave do të bashkëpunojë me të gjitha subjektet e brendshme dhe me ato ndërkombëtare të përfaqësuara në Kosovë. Në takimet e veta do të ftojë ekspertë fushash përkatëse. Gjithë ashtu, sipas nevojës do të organizojë edhe degjime publike me qëllim të marrjes së opinioneve për çështje të caktuara. Në kuadër të funksioneve të veta Komisioni, rëndësi të veçantë do t'i përkushtojë edhe kontrollit të ministrive të fushës përkatëse në veçanti zbatimit të legjislacionit dhe nxjerrjes së akteve të tjera nënligjore të fushës përkatëse. Komisioni yne poashtu do të bashkëpunoj ngusht me komisionet tjera të Kuvendit, më qëllim që të bashkërendoj veprimtarinë e saj.

Ajo propozoi që Komisioni të punojë-mbajë mbledhje të rregullta çdo dy javë, dhe dita e martë të caktohet si ditë e takimeve, duke filluar në orën 10.00. Ndërsa mbajtja e mbledhjeve dhe orari i mbajtjes do të përshtaten rrethanave dhe kërkesave eventuale.

Në fund ajo kërkoi nga të pranishmit që në funksion të mbarëvajtjes së punës së Komisionit anëtarët të jenë në nivel të detyrës, të kultivohet fryma e bashkëpunimit të tolerancës e mirëkuptimit dhe të të gjitha cilësive që janë parakusht për rezultate sa më të mira për Komisionin e ETIETT përfundoi Kryetarja Selmani.

Në vazhdim e morën fjalën edhe anëtarët e tjerë të pranishëm dhe në tërësi u pajtuan me fjalën e kryetares duke arsyetuar e propozuar që mbledhjet e Komisionit të organizohen dhe të procedohen në baza juridike gjegjësisht në pajtim me aktet juridike përkatëse. Për çështje specifike puna të organizohet në grupe e nëngrupe, debati konstruktiv të jetë trajtë shqyrtimi, pjesëmarrja e përfaqësuesve dhe e ekspertëve të subjekteve të jashtme e të brendshme sipas nevojë, transparenca, koordinim, bashkëpunimi si dhe të gjitha format e tjera të punës që parashihet Rregullorja dhe Komisioni të jenë forma të punës.

Nga diskutimet e përgjithshme mbledhja përfundoi me këto konkluzione:

- mbledhjet e Komisionit të jenë të rregullta dy javore, të mbahen të marteve, të fillojnë në orën 10.00 me përjashtim të javës kur mbahet seanca e Kuvendit;
- mbledhjet të mbahen edhe sipas dinamikës dhe vëllimit të punëve që duhet të kryhen;
- mbledhjet të organizohen dhe procedohen në pajtim me Rregulloren e punës dhe me aktet tjera përkatëse;
- për çështje të veçanta, komisioni organizonë shqyrtime e trajtime në grupe pune;
- mbledhjet e Komisionit t'i përshkon fryma e debatit konstruktiv e tolerant;
- të avansohet bashkëpunimi me Qeverinë dhe me ministrinë si dhe me institucionet e tjera përkatëse;
- të avansohet bashkëpunimi i ndërsjellë me komisionet e tjera të Kuvendit;
- të ushtrohen format e kontrollit kompetent, ndaj Qeverisë dhe Ministrive përkatëse;
- të vehen kontakte bashkëpunimi me ndërmarrësit publikë e private si dhe të këmbehen vizita pune;
- në mbledhjet e Komisionit të ftohen dhe të jenë pjesëmarrës, përfaqësuesit e AER dhe USAID-it e tjerë, si dhe ekspertët vendorë e të huaj për fushat specifike;
- të favorizohen dhe të avansohen bashkëpunimi i ndërsjellë dhe vizitat të shpeshta me subjektet përkatëse të vendeve fqinjë dhe të Evropës;
- në rast inicimi dhe hartimi të projektligjeve nga Komisioni, të angazhohen ekspertë vendorë e ndërkombëtarë (paga të sigurohet mundësisht nga AER);
- sipas nevojës të organizohen edhe degjime publike;
- të sigurohen adresa të institucioneve përkatëse për venje kontakti;

4. Te ndryshme – në këtë pikë Kryetarja i njoftoj anëtarët e Komisionit për mbledhjen e mbajtur me datë 11.02.2008 me kryetarin e Kuvendit z.Krasniqi i cili i ka njoftuar se për seancën e radhës do të jetë shqyrtimi i projektligjit për buxhetin e Kosovës 2008. Andaj kërkoj nga anëtarët e Komisionit që të caktohet një grup punues për shqyrtimin e Buxhetit të Kosovës 2008 dhe të Agjensive përkatëse si të ART-së, KPMM-së dhe ZRRE-së. Njiherit ky propozim i miratua nga të gjithë anëtarët e Komisionit dhe u formua Grupi në këtë përbejrrë: Myzejene Selmani, Berim Ramosaj, Safete Hadergjonaj si dhe u tha që cili do anëtar i Komisionit mund të jep propozimet e veta lidhur me këtë çështje.

Mbledhja e radhës u caktua më datë 14.02.2008 me rend të ditës: shqyrtimi i projektligjit të buxhetit të Kosovës 2008.

Mbledhja përfundoi në orën 10.40

Kryetarja e Komisionit:

Myzejene Selmani